



**Nga Plaku
Valeri V. Kordon,**
i Të
Shtatëdhjetëve

Një Mësim i Mrekullueshëm



*“Unë . . . do t’i hap pragjet e
qiellit dhe . . . do të derdh mbi ju . . . shumë
bekim” (Malakia 3:10).*

Kur po rritesha në Guatemalë, familja ime zotëron-
te një fabrikë që prodhonte uniforma për ekipe
sportive.

Babi im dëshironte që fëmijët në familjen tonë të
mësonin se si të punonin shumë. Ne e ndihmonim atë
në fabrikë. Unë hyra goxha në telashe kur isha i vogël.
Gjithmonë dukej se i prishja gjërat! Por, kur u rrita, babi
më lejoi të kujdesesha për makinat qepëse.

Babi na paguante për punën që bënim. Më pas do të
pyeste: “Çfarë do të bëni me paratë tuaja?” Unë e dija se
cila ishte përgjigja e saktë: “Do të paguaj të dhjetën dhe
do të kursej për misionin tim”.

Kur isha rreth 13 vjeç, sipërmarrja jonë humbi shumë
para. Na u desh t’i hiqnim shumë prej makinave tona
qepëse. Në vend që të kishim dyqind punonjës, nuk
kishim as pesë. Ata punonin te garazhi i shtëpisë sonë.

E kisha paguar gjithmonë të dhjetën time, por kurrë
nuk e kisha kuptuar vërtet se sa e rëndësishme ishte.

Atëherë mora një mësim të mrekullue-
shëm. Një mëngjes të shtune dëgjova prin-
dërit që po flisnin me zë të ulët. Babi po i thoshte mamit
se kishte aq para sa ose të paguante të dhjetën ose të
blinte ushqim. Nuk kishte mjaft sa për të dyja. U shqetë-
sova. Çfarë do të bënte babi im?

Të dielën e pashë babin tim t’i dorëzonte një zarf pre-
sidentit të degës sonë. Ai zgjodhi ta paguante të dhjetën!
Isha i kënaqur që e pagoi, por isha dhe i shqetësuar.
Çfarë do të hanim?

Të nesërmen në mëngjes disa njerëz trokitën në
derën tonë. Ata i thanë babit tim se iu nevojiteshin
uniforma menjëherë. Zakonisht njerëzit na paguanin
pasi porosia të përfundohej. Por këta njerëz e paguan
babin tim po atë ditë, madje përpara se ne t’i bënim
uniformat!

Brenda një fundjave, unë mësova një mësim të bukur
që e kam ruajtur gjatë gjithë jetës. Ligji i së dhjetës na
ndihmon ta ngremë besimin tonë dhe ta tregojmë mirë-
njohjen tonë për Atin Qiellor. Pagimi i së dhjetës është
një bekim! ■